


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

100 Vjet Pavarësi

Nr. 2700 / Prot, Datë 14.05.2012

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit


Z. Hysni BURGAI



Nr. 5901 Prot, Datë 14.05.2012

Drejtor i Përgjithshme e Sh.Transportit Rrugor

Z.Arben PINARI




MEMORANDUM BASHKEPUNIMI

Nr. Prot. 1406, Datë 15.05.2012

Prokurore e Përgjithshme


Znj. Ina RAMA



Nr. Prot. 7600, Datë 14.05.2012

Drejtor i Përgjithshem i Doganave

Z. Flamur GJYMYSHKA



Për krijimin e njësisë së përbashkët "TASK-FORCË", me objekt parandalimin dhe hetimin e veprave penale që lidhen me trafikimin, kontrabandimin, shhangjen e detyrimeve doganore, fallsifikimin e dokumentacionit dhe shkeljet administrative etj nëpërmjet monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2012 - 2014 nr.284 date 09.05.2012: "Per parandalimin dhe goditjen e veprimtarise kriminale te trafikimit te mjeteteve motorike te vjedhura, kontrabanduara dhe me shkelje te tjera ligjore".

Hyrje

Duke vlerësuar nevojën për bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimtarisë ndërinstitucionale në luftë kundër fenomeneve që lidhen me trafikimin, kontrabandimin, fallsifikimin dhe shkeljet administrative në lidhje me mjetet motorrike, si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Veprimit "Për Parandalimin dhe Goditjen e Veprimtarise Kriminale të Trafikimit të Mjeteve Motorike të Vjedhura, Kontrabanduara dhe me Shkelje të tjera Ligjore", me qëllim marrjen e masave për analizimin e fenomenit, tendencave e dukurive te shfaqura gjate ketij aktiviteti kriminal si dhe me qellim kontrollin dhe kryerjen e operacioneve policore në të gjithë territorin e Republikës së Shqiperisë, për identifikimin e automjeteve me shkeljet e mësipërme, dhe procedimin ligor të autorëve të këtyre shkeljeve, lind e domosdoshme krijimi i një njësie "Task-Forcë" ndërmjet institucioneve të ngarkuara me zbatimin e planit të veprimit të mësipërm, i cili do të planifikojë dhe koordinojë punën e njësive taktike operacionale në vazhdimësi.

Sa më sipër, palët pjesëmarrëse bien dakort të nenshkruajne këtë memorandum bashkëpunimi:

Neni 1 **Parime të Përgjithshme**

Kjo marrëveshje synon të rrisë dhe forcojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të ngarkuara me ligj, për parandalimin e fenomenit të trafikimit të mjeteve motorike, kryerjen e procedurave te rregullta ligjore, shkëmbimin e informacionit, monitorimin e këtij fenomeni, procedimin administrativ ose penal ndaj autorëve të shkeljeve, plotësimin e boshllëqeve të konstatuara gjatë ndjekjes së rasteve etj. Njesia e Përbashkët "Task Forcë" në nivel qendror, e cila do të jetë në nivel strategjik do te sherbeje per analizimin e tendences se trafikimit te mjeteve motorike, fenomenin ne teresi si dhe do te monotoroje zbatimin e Planit Kombtar te Veprimit per kete qellim. Gjithashtu do te nxjerre rekomandime detyrimisht te zbatueshme ne kete drejtim per institucionet pjesmarrese ne nivel lokal si dhe do orientojë aktivitetin e strukturave vendore e në rast të identifikimit të problemeve specifike në një qark të caktuar, ku do të ngrihen njësi të përbashkëta.

Neni 2 **Institucionet Zbatuese**

Institucionet dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e marrveshjes janë:

- Prokuroria e Përgjithshme
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Institucionet zbatuese informojnë njëra - tjetren, për ndryshimet e strukturave të tyre si dhe kompetencat e secilës në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 3 **Task-Forcë në nivel strategjik**

Njesia Task Forcë do të operojë si një organ monitorues dhe koordinativ, ku nga analiza e fenomeneve dhe ekspertiza e përbashkët, do të hartohen detyra strategjike, plane operacionale, e rekomandime qe do te konsistojne ne ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me fenomenin, në interes të bashkëpunimit në lidhje me hetimin e këtyre veprave penale dhe rritjen e efikasitetit te luftes kunder ketyre fenomeneve ne kuadrin nderinstitucional.

Task Forca në nivelin strategjik do të rekomandoje detyra specifike për institucionet kombëtare përgjegjese gjatë procesit të trajtimit të makinave si regjistrimi, zhdoganimi, verifikimi, identifikimi etj, me detyra që lidhen me bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimtarive midis tyre, me detyra për shkëmbim të shpejtë të informacioneve dhe krijimin e lidhjeve online për verifikim, me detyra për përfundim të hetimeve dhe dënimive të sukseshme të trafikanteve dhe

bashkëpuntorëve të tyre, me rekomandime për trajnime e krijimin e kapaciteteve si dhe detyra për rritjen e ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me kete fenomen.

Task Forca në nivel strategjik do të përbëhet nga një përfaqesues prej institucioneve Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, do të ketë nga një përfaqesues prej Drejtorisë Kundër Narkotikëve dhe Trafikeve, Drejtorisë Kundër Krimit Financiar, Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale, Drejtorisë së Shërbimeve Operacionale të Kufirit, Drejtorisë së Policisë Rrugore dhe Zyres Qendrore Kombetare "Interpol Tirana". Njësia Task Forcë do të kryesohet nga përfaqësuesi i Policise së Shtetit. Njësia do të ketë bazën (zyrën) në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policise së Shtetit, ku do të zhvillohen takime periodike (3 mujore) ose sipas specifikave e nevojave të antarëve të task forcës, për të shqyrtuar problematikat e evidentuara dhe planifikimet për veprimtarinë vijuese ose për hetime a operacione të përbashkëta si dhe shkëmbim informacioni.

Neni 4 **Task-Forcë në nivel operacional**

Task - Forca në Nivel Operacional nëse kërkohet, do të organizohet në bazë qarku dhe do të jetë ekip me përbërje nga përfaqësues të policisë në qarqe (strukturat kundër trafeve të paligjshme, strukturat e operacioneve speciale dhe kërkimit, strukturat e policisë rrugore, drejtorite e policisë rajonale të kufirit & migracionit dhe specialistët e drejtorisë rajonale të doganave e te drejtorive rajonale te sherbimeve te transportit rrugor dhe do të fuksionojë si njësi që ndjek:

- Kërkimin dhe vlerësimin e informacioneve që bëjnë fjalë për veprat penale të mësipërme;
- Identifikimin e rasteve të mjeteve motorrike me shkelje ligjore dhe administrative;
- Bashkërendimin dhe mbështetjen e strukturave të parashikuara në këtë nen;
- Detyra të tjera që mund të dalin në dinamikë;
- Monitorimin e operacioneve ne nivel lokal e kombëtar.

Neni 5 **Angazhime të përbashkta**

Antaret e njësisë Task Forcë duhet të jenë me përvojë në fushën e veprave penale që do të ndjekin, duhet të kenë integritet të lartë moral e profesional, mundësishët të kenë marrë pjesë në kurse trajnimi specifik për këto vepra penale. Secili institucion të përgatisë materialet përkatëse për qëllime trajnimi për Task Forcën (të nxjerra nga ligjet, aktet nënligjore, udhëzimet përkatëse, etj).

Neni 6 **Veprat penale që do të hetohen**

Njësia Task Forcë do të ketë kompetencë koordinimin dhe bashkërendimin e punës në lidhje me veprat penale të parashikuara nga:

1. Neni 141/a , "Trafikimi i mjeteve motorrike"
2. Neni 186, "Fallsifikimi i dokumentave zyrtare"
3. Neni 190, "Fallsifikimi i vulave dhe i stampave"
4. Neni 176, "Kontrabanda me mallra të tjera"

5. Neni 244, "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike" (doganieri, punonjesi i policise në PKK, specialisti i D.R.SH.T.RR-së, etj)
6. Neni 148, "Shpërdorimi i detyrës", etj.

Neni 7
Masat e marra nga institucionet përgjegjëse

Nga institucionet pjesmarrëse, punonjësit që do të janë pjesë përbërëse e Njësisë Task Forcë në Nivel Strategjik dhe Operacional te jene ne kontakt te vazhdueshem me njeri tjetrin nepermjet mjeteve te komunikimit elektronik ose direkt.

Kur gjatë hetimit të veprave penale të parashikuara rezultojnë dyshime të arsyeshme se janë kryer vepra penale të tjera, njesitë operacionale të referojnë materialin në prokurori edhe për këto vepra penale.

Neni 8
Dispozita përmbyllëse

Ne rastet e ndryshimeve strukturore ose emërimet e antarëve të Njësisë Task Forcë në funksione të tjera, atëherë institucioni përkatës do të bëjë zëvendësimin e antarit të njesisë Task Forcë si dhe të njoftojë për emërtimin e strukturës përkatëse pas ndryshimeve.

Neni 9

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi menjëherë.

ANEKS: I

Personat përgjegjes pjese e njesise "TASK FORCE" të institacioneve pjesëmarrëse të kësaj marrëveshje mirëkuptimi janë:

- **Z. Jonad BARE** email: jbare@pp.gov.al & tel +355 694113003
(Prokuroria e Përgjithshme)
- **Z. Dritan SHORAJ** email: d_shoraj@dogana.gov.al & tel +355 692090320
(Drejtoria e Pergjithshme e Doganave)
- **Znj.Kozeta GINA** email: kozetagina@yahoo.com & tel +355 672059125
(Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor)
- **Z. Ndue DOÇI** email: docin@mrp.gov.al & tel +355 694102798
(Policia e Shtetit / Drejtoria Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve)
- **Z. Idajet FASKAJ** email: faskaji@mrp.gov.al & tel +355 694102176
(Policia e Shtetit / Drejtoria Kundër Krimtit Financiar)
- **Z. Andi HASANAJ** email: hasanaja@mrp.gov.al & tel +355 694102001
(Policia e Shtetit / Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale)
- **Z. Ferdinand GJETA** email: gjetaf@mrp.gov.al & tel +355 694107756
(Policia e Shtetit / Drejtoria e Shërbimeve Operacionale të Kufirit)
- **Z. Ismail ALIA** email: alai@mrp.gov.al@mrp.gov.al & tel +355 694104964
(Policia e Shtetit / Drejtoria e Policisë Rrugore)
- **Z. Toni BENI** email: benit@mrp.gov.al & tel +355 694111532
(Policia e Shtetit / Interpol Tirana)